

POPULIZMI ËSHTË KARAKTERISTIKË E DEMOKRACISË

Intervistë e Filip Nelkovskit me prof. dr. Ismail Bardhin
për "FORUM ANALITIKA"
pranverë 2007

Zotëri Bardhi është një nga ato personalitete me të cilët mund të bisedoni me orë të tëra për tema të ndryshme. Si teolog, me të është jashtëzakonisht interesante të debatohet për linkun mes religjionit dhe populizmit. Thotë se populizmi nuk i sulmon institucionet demokratike, por se vetëm i minon ato dhe se populizmi, në të vërtetë, është formë moderne e asaj që ne e njohim si demokraci. Flasin edhe për multikulturalitetin dhe qytetërimet, për marrëdhënien grupore mes populizmit, demokracisë dhe masës, për qëllimet legjitime të politikës, për të vërtetën, për përkufizimin e njeriut...

F. Nelkovski: *Për fat të keq, si duket assesi nuk mund të gjendet paqe e qetësi për njeriun, pavarësisht nga zhvillimi shkencor dhe "izmat" e shumta. Njëri nga ato "izma" që pak përdoret, e që nga ana tjetër është mjaft i pranishëm, është edhe "populizmi". Si mund ta përshkruani populizmin në hapësirën tonë? Cila është lidhja mes populizmit dhe religjionit?*

I. Bardhi: Pajtohem me atë se nga dita në ditë njeriut i vështirësohet dhe ndërlikohet ekzistenca, pavarësisht nga përgjegjësia të cilën ai si njeri e ka. I përkufizuar me emra të ndryshëm, si qenie më e lartë, por edhe si shtazë (teoria e Darvinit – mohuesit e të cilës tek ne burgoseshin), njeriu flijoji çdo gjë vetëm që të bëhet modern, flijoji edhe atë që i thanë dhe që ia lanë të vjetrit, vetëm për arsye të "lirisë", e cila tashmë ka marrë formën e dhunës, të pasigurisë dhe të kotësisë. Disa që moti kanë thënë se "përparimi" nuk i ka sjellur gjë tjetër njeriut, pos që "e ka përsosur vetëm prodhimin e mjeteve për mundim" (Kanti), ose siç thotë Kur'ani: "vërtet njeriu është në humbje të sigurt, përpos të besueshmëve dhe mirëbërësve".

Sa u përket "izmave" të ndryshëm, më së miri është që ato t'i pranojmë ashtu siç janë dhe në një mënyrë t'u falënderohemi për atë se e dëshmojnë evoluimin e kuptimeve "të brendshme" dhe "të jashtme" të gjërave që i mundësohet mendjes së njeriut. "Izmi" mund të konsiderohet edhe si shenjë e kohës. Ç'do të thotë kjo? Ai ndoshta e shpreh përhapjen dhe shtimin e forcave dominuese të cilave u është ekspozuar lakuriqësia ekzistenciale e shekullarizmit, e për shkak të kësaj edhe njeriu i pambrojtur. Si duket ky përforcim i presioneve mbi njeriun është i përpjestueshëm me përsosurinë dhe përhapjen e rrjetave të sistemeve për komunikime dhe manipulime masive, si pasojë e drejtpërdrejtë e tyre. Shenja e njëjtë e kohës mbase i shpreh edhe proceset e "dobësimit të rezistencës së njeriut" (Kalajiq) ndaj presioneve të jashtme dhe forcave determinuese.

Sa i përket "populizmit", si e para me gjasë as shqiptarët e as maqedonasit nuk do të na e zënë për të madhe, për shkak se në këtë rast as të parët e as të dytët nuk do të kenë nevojë për përkthimin e tij (shaka). E megjithatë, për fat të keq, në fjalorët tanë nuk hasa në shpjegim të këtij

nocioni. Mbase i njëjti konsiderohet si shprehje e huaj, edhe pse në masë të madhe është i pranishëm mes nesh. Pavarësisht nga kjo, sërish duhet të them se nuk kam hasur as në interpretim të “përmbajtjes” së këtij nocioni. Prandaj, këtu do të ishte mirë që të përmenden disa interpretime të tij, si ai i Paul Taggartit, i cili thotë: “Populizmi u bë instrument i progresistëve, reaksionarëve, demokratëve, autokratëve, të së majtës dhe të djathtës. Arsyeja për përshtatshmërinë e tij aq të lartë qëndron në faktin se është ‘pa shpirt’: atij i mungon lidhja me vlerat fundamentale...” Disa populizmin e konsiderojnë si formë të demokracisë moderne, në të cilin ekziston një raport i çuditshëm mes demagogjisë dhe masës: demagogu dëshiron t’i përfitojë masat dhe fillon të flasë atë që dëshiron ta dëgjojë masa. Mirëpo, pas një kohe ai më nuk guxon të flasë asgjë tjetër. Fillimisht ishte ai që i mashtronte masat, e pastaj masat e mashtruan atë. Është e qartë se pothuajse gjithkund në shoqëri vërehet ndikimi i populizmit, me qëllim të vetëm të dominimit të tij. Personalisht mendoj se tek ne populizmi ka marrë disa karakteristika të definicionit të Ibn Haldunit për “*asabiye*”. Me populizmin nuk dihet se kush është më i keq, ai i cili e shfrytëzon atë për qëllime personale, apo masa e cila ia mundëson atë.

Që kjo të cilën e thamë deri më tani mos të mbetet e thatë, unë po i marr disa shembuj për atë se në ç’mënyrë është duke u manifestuar kjo dukuri tek ne: shumë ngjarje “të rastësishme” kanë ndodhur, e pas tyre sërish ka qëndruar masa. Kemi parë kryetarë pa shtet; luftë në formë loje të shahut; unë do lëviz këtu ti atje; ose luftë pa luftë; shumë komandantë pa ushtarë; të burgosur për kriminalitet që bëhen kryeministra; burrë shteti i akuzuar për kriminalitet; “lider” i masës, por që nuk din të flasë vet, etj. Paramendoni mbi këtë mentalitet të krijohet dhe ndërtohet historia dhe qetësia njerëzore. A nuk është kjo e kobshme dhe ofenduese për kulturën e shtetit?

F. Nelkovski: *Mendoj se nuk iu përgjigjët tërësisht pyetjes për lidhjen mes populizmit dhe religjionit, apo mbase për atë se si e vlerësoni lidhjen mes religjionit dhe politikës?*

I. Bardhi: Po, qëllimisht e bëra këtë, sepse çdo gjë që ka ngjashmëri me diçka nuk do të thotë se esencialisht i takon asaj. Siç thashë më lart, populizmi, demokracia, masa janë ato që për momentin janë duke bërë një “marrëdhënie grupore” dhe historia e tyre dihet. Që nga antikiteti e deri më sot autorë të shumtë kanë shkruar dhe shkruajnë për këtë. E dini rastin e mbrojtjes së Sokratit i cili në fund u përpoq të “shpëtojë” me helm nga urdhri me vdekje në “emër të popullit”. Është shumë interesante se këtu të gjorit Sokrat nuk i ndihmoi argumenti i mbështetur nga masa. Nga ana tjetër religjioni nuk mund të futet në këtë kornizë mendore. Përkufizimi i religjionit dihet: besimi në një Zot, i Cili nuk mashtrohet, nuk mashtron, i Cili është Krijues i Gjithësisë, Krijues i Sekretit dhe Mbikëqyrës i saj, ose Lëvizësi i Parë (sipas filozofëve). Edhe vet mohimi i Zotit e dëshmon ekzistimin e Tij. E shihni se këtu nuk ka vend për populizëm, apo ndonjë “-izëm” tjetër, dhe ajo të cilës më së tepërmi i frikësohet populizmi është pikërisht ky raport.

Kur teologjia me urtësinë e saj flet për raportin e njeriut me Zotin ajo kërkon pastërtinë më të madhe dhe fare nuk lejon të ndërhyjë mbështetje individuale, e lëre me populizmi. Kjo do të thotë se nëse një njeri bën një vepër të mirë me qëllim që ta shohin të tjerët, jo që për të nuk ka asgjë të mirë nga kjo, por konsiderohet nga mëkatet më të mëdha si

shirk/politeizëm, sepse është munduar ta involvojë elementin më të imët që kontakton me forcën e “populizmit”.

Shikuar nga perspektiva e të dërguarve të Zotit vërehet se ata me ardhjen e tyre aspak nuk kanë pasur për qëllim që të gjejnë mbështetje tek masa për “afirmimin” e vet, dhe edhe pse në shumë raste kanë ngelur të vetmuar, megjithatë janë përpjekur deri në fund që krahas me thirrjen e tyre për ta prezentuar shpalljen njëkohësisht ta luftojnë edhe tiraninë. Ky moment shpesh herë është karakterizuar si radikalizëm. Por pse radikalizmi i këtillë është konsideruar si i keq, për arsye se në mënyrë të drejtpërdrejtë e zbulon të ligën. Urdhëroni thuani dikujt se është vjedhës! Menjëherë plas sherri.

Pas gjithë kësaj, po ashtu edhe nga fakti që vet jam teolog, në një mënyrë jam shumë i lirë të flas për politikën. Sipas definicionit të Morenit, i cili politikën e përkufizon si “kurvë”, natyrisht se nuk kam dëshirë që ajo të jetë as fqinjë me religjionin, por me qenë se metaforat e tilla nuk na ndihmojnë shumë po i kthehem realitetit. Politika sot është bërë një domosdoshmëri dhe disiplinë studimi. Sa për religjionin nuk mund të them me bindje se ai është apolitik, sepse tek e fundit në interesin e mësimit religjioz qëndron njeriu. Që këtu religjioni nuk është politik në kuptimin e politikës ditore, por në atë të përmirësimit dhe humanizimit të ideve pa të cilat njeriu, e me këtë edhe politikani, nuk mund të jetojë. E tani a jemi duke dëshmuar politizimin e religjionit, gjithsesi dhe për fat të keq po. Teologu i njohur katolik Hans Küng, duke shqyrtuar me kritikë rrjedhat negative të botës moderne, siç janë koha e kaluar kot, pafesia e diturisë dhe shkencës, kriminaliteti, sida, droga, promiskuiteti, në përgjithësi e gjithë ajo që e poshtëron dinjitetin e njeriut, do të thotë se Krishterimi shumë lehtë e ka pranuar parimin e depolitizimit të religjionit. Në fakt shumë lehtë e ka pranuar idenë për shekullarizimin e diturisë dhe shekullarizimin e jetës. Ai konsideron se kisha e krishterë është bashkëpërgjegjëse për gjendjen e mendjes së njeriut modern. Mirëpo, çështja e parë është ideologjishmëria e religjionit. Megjithatë, unë nuk jam për idenë e paneklezizalizmit, as për idenë e evropocentrizmit, nuk jam as për idenë e panislamizmit – këto janë ide ideologjike. Si të tilla ato nuk kontribuojnë për kohabitimin e ideve, njerëzve dhe qytetërimeve që pikërisht gjendet në vetë qendrën e *religio perennis*. Fetë qiellore nuk guxojnë të izoloohen dhe të heshtin para sundimeve populiste, e sidomos padrejtësive.

F. Nelkovski: *Me çka karakterizohet populizmi bashkëkohor? A mund të ketë ai rrënjë në religjionin dhe a ka elemente religjioze në populizmin politik?*

I. Bardhi: Me çdo gjë, por më së shumti me gojën plot demokraci, ajo është më se e nevojshme që populizmi të vijë në pushtet. Prandaj, populizmi kurrë nuk i sulmon institucionet demokratike, por i minon ato duke i kontaminuar me të dëgjueshmëri të vet dhe duke thënë se kësaj e ka legjitimitetin e plotë demokratik. Fjala “bashkëkohor” disi më tingullon shumë ftohtë, dhe nuk e di se sa është e dobishme që ta bashkëkohorizojmë këtë dukuri pa bashkëkohësi, për shkak se, ashtu siç e quajtmë më sipër ‘pa shpirt’, mund të themi se është bashkëkohësim pas-shpirtëror. Por, si duket nuk bëhet fjalë për atë se sa është bashkëkohës, por kush është më dominues. Çështja qëndron aty se populizmi bashkëkohor lokal është vetëm edhe një “i dëgjueshëm” i populizmit më të madh bashkëkohor, gjegjësisht i atij global.

Këtu nuk mundemi ta themi atë që duhet, apo të vërtetën, në qoftë se nuk futemi pak më gjerësisht në ngjarjet në disa vende dhe sisteme të ndryshme në botë, sepse ndikimi që është i pranishëm në Perëndim nuk përputhet me atë në Lindje dhe anasjelltas. Por në fakt çdokund nuk kursehet asgjë për të ardhur në pushtet, pra as religjioni. Me dhembje e them se në Lindje, apo në të a.q. “Botë Islame” në mënyrë drastike janë duke u shkelur pothuajse të gjitha normat, ashtu që nga padrejtësitë e mëdha muslimanëve thjesht nuk u lejohet që të marrin pjesë në përmirësimin e gjendjes dhe lirive elementare.

F. Nelkovski: *Sipas jush a është populizmi mjet legjitim për realizimin e qëllimeve politike dhe a karakterizohen elitat politike në Maqedoni me populizëm?*

I. Bardhi: “Populisti” i njohur Nasradin Hoxha do të përgjigjej: edhe po edhe jo, por unë do të thoja se nuk është dhe nuk duhet të jetë legjitim, sepse siç thashë tanimë politika ka filluar ta marrë një formë tjetër, të bëhet disiplinë dhe mjeshtri e udhëheqjes së shtetit, pa marrë parasysh se kemi edhe fëlliqësira të mëdha të cilat meritojnë urrejtje dhe dënim. Nëse kësaj “loje” të quajtur politikë ia shtojmë edhe globalizmin, atëherë Zoti na ndihmoftë. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se tallem me rolin e globalizmit, por më habit ajo se kjo gjeneratë e jona ka parë shumë gjëra: “njerëzit” brenda natës që ndryshojnë qëndrime, vendime, ideologji dhe, për fat të keq, edhe besime. Po ashtu pamë se si me populizëm, të pasqyruar në një person të retarduar, u shkatërrua një shtet i përbashkët, pasojat e së cilës jami duke i përjetuar në aspekte të shumta politike, kulturore, ekonomike e mos të flasim për atë etik, sepse fotografitë e masakrave dhe burgosjeve nuk guxojnë të harrohen. Më e keqja në këtë është se si përkrahësit e “sistemit” të tillë do t’i përgjigjen vetvetes. Ata asgjë nuk fituan. Ashtu është kur e vërteta dhe e drejta largohen nga mbështetja e tyre, do të thotë nuk janë bazë mbi të cilën do të rindërtohej sistemi dhe sundimi.

E vërteta është fuqi në vete, e cila paraqitet në mënyra të ndryshme dhe nuk i takon kohës, ajo pandërprerë e përcjell njeriun. Ajo e përbin njeriun edhe natën, sepse nuk është prodhim njerëzor, ajo është diçka që është nga Perëndia. E vërteta është ajo për të cilën njeriu jeton dhe ka se pse të jetojë. Po mos të ishte e vërteta humb përkufizimi i njeriut. Ai mezi pret mëngjesin që të zgjohet dhe të bisedojë me familjen, me fëmijët, me studentët, me kryetarët e shteteve për shkak të së vërtetës. Ajo disa herë njeriun e bën të çmendet, vetëm e vetëm që ta mbrojë atë. E vërteta nuk ka ngjyrë, nuk ka erë, nuk ka vend, ajo është vetëm se prej Zotit. E nëse ne e arrijmë këtë lloj sundimi mbi të vërtetën dhe të drejtën atëherë kemi qetësi dhe paqe, pavarësisht se kjo mund të na shkaktojë dhembje ose hidhuri. “Më e vështirë për lirinë është në kohën kur çdo gjë mund të jetë e vërtetë” (S.J. Lec).

A nuk e shihni se jemi bërë maskarenj në politikë, në kulturë, në marrëdhëniet ndërnjerëzore, pandërprerë shahet e kaluara, ndërsa fantazohet e ardhshmja; pandërprerë pranohen gjërat të cilat nuk përputhen me logjikën e shëndoshë.

Sa i përket “elitës” politike tek ne, është vështirë të thuhet se kemi pasur një të tillë, ajo edhe në të kaluarën “ekzistonte” sepse duhej të ishte, pa marrë parasysh si dhe pse. Nëse kjo konsiderohet, e duhet të konsiderohet si elitë politike, atëherë na paraqiten shumë pyetje përgjigjet e të cilave janë mes “realitetit” dhe “qesharakes”. Papërvoja e kësaj elite është dëshmi edhe e

post-tranzicionit. Lirisht mund të thuhet se në hapësirën e Ballkanit, pra edhe te ne, elitat politike janë duke e imituar njëra-tjetrën, por parashtrohet pyetja se cila mund të merret si paradigmë, si model: Serbia, Shqipëria, Bullgaria apo madje edhe Greqia?!?

F. Nelkovski: *Cili është roli i medimeve në shoqërinë maqedonase dhe a kanë ato përgjegjësi për gjendjen në të cilën gjendet shoqëria?*

I. Bardhi: Pa dyshim se roli i medimeve, informacioneve është i pakontestueshëm. Siç e dini më mirë se unë, ju të medimeve konsideroheni edhe si fuqi e shtatë, d.t.th. keni hyrë në terminologjinë e “fuqisë”. Edhe kjo “fuqi” qëndron mes të voglit dhe të madhit, të fortit dhe të dobët; të fuqishmit dhe të pafuqishmit. Cilën mjeshtri, mençuri do ta përdorë mediumi që ta ruajë vetveten dhe profesionalizmin e vet, është pyetje të cilës si duket pandërprerë do të duhet t’i përgjigjemi dhe asnjëherë nuk do të jemi të kënaqur. Një fuqi e këtij lloji, siç është bota e informacionit, bota e medimeve, nëse pandërprerë mundohet të merr mbi vete diçka që nuk i takon, do të ballafaqohet me një fund shumë të trishtueshëm, sepse rolin e vet e ka keqpërdorur. Për fat të keq, e kaluara e kësaj fuqie në hapësirën e Maqedonisë nuk ka një histori me të cilën mund të mburret, sepse nuk ka dashur të jetë e pavarur, por vetëm se nëpërmjet dëgjueshmërisë është munduar të jetë pjesëmarrëse e kësaj fuqie të madhe.

Sa për një ilustrim do të ndalemi në të kaluarën. Preokupimi kryesor i mediave tona ishte “prishja” e mureve në vendin tonë, “separatizmi”, “radikalizmi” dhe “fundamentalizmi”. Më vjen keq përse nuk jemi bërë të parët që në atë kohë ta kishim luftuar edhe “terrorizmin”? Si do të mund t’i përgjigjeni pyetjes që shumica e burgjeve asokohe kanë qenë të mbushura me “aktivistë politik”? Urdhëroni, a kanë qenë këto çështje me rëndësi? Si është e mundshme të jetë me rëndësi që aq shumë të shkruhet për “muret” e atëherëshme, kurse sot i tërë qyteti është shndërruar në një qendër ndërtimi, pa asnjë trotuar dhe vend parkimi. Sa keq është dhe sa e dhimbshme është angazhimi të cilit i mungojnë e vërteta dhe e drejta. Mjerim është që një fuqi si kjo e mediave mos të jetë në gjendje të bëjë dallimin mes gabimit dhe të drejtës.

Për fat të keq, e njëjta metodë është duke u përdorur edhe për “prodhimet” e ndryshme të rasteve inekzistentë, të cilat vetëm për arsye se servohen nga “fuqitë e mëdha”, mediat tona i pranojnë si të gatshme. Kjo “lojë” e madhe e kësaj bote të informacionit besoj se së shpejti do të dalë në shesh. Unë mendoj se gazetarët nga vendet dhe popujt e vegjël kanë për obligim që t’i çmontojnë lajmet e montuara përplot konsipacion dhe mashtrim. Roli i juaj është me të vërtetë i madh, sidomos për mentalitetin tonë “populist”. Është fakt se edhe ju e keni të vështirë të veproni në mesin e “liderëve” që e konsiderojnë veten “zot” dhe brenda ekonomisë së dobët. Por kjo nuk do të thotë se duhet të nënshtroheni dhe të bëheni shërbëtorë; ju gazetarët duhet patjetër të përdorni metodat më të mira, më të përkryera, të cilat i ndihmojnë shoqërisë ta kalojë këtë periudhë të tranzicionit apo post-tranzicionit. Informacionet duhet të analizohen shumë mirë dhe pastaj të jepen apo publikohen. Me lejoni që si teolog ta parafrazoj një thënie kur’anore, e cila thotë: “nëse ndonjë i pandershëm (fasik) u sjell ndonjë lajm, sqarojeni mirë...”

Që të bëhem pak paradoksal, para disa ditësh në Turqi u liferua një lajm kinse do të ndodhë tërmet brenda dy orësh: i tërë populli në ora 1 pas

mesnate doli jashtë shtëpive të tyre. Pikërisht siç ishte rasti me radio dramën e Orson Wellesit për sulmin e marsianëve.

F. Nelkovski: *A mund të jetë religjioni bazë e asaj që disa teoreticientë e mbështesin si përlëshje mes qytetërimeve?*

I. Bardhi: Historia është përplot me shembuj mbi të cilat edhe ne mund t'i mbështesim interpretimet tona duke u bazuar edhe mbi përlëshjen mes qytetërimeve dhe mes kulturave. Nuk është tabu temë as lufta e kryqëzatave; nuk është tabu temë as ajo që ndodhi në hapësirën tonë të përbashkët, këtu në Ballkan. Çdokund që ndodhi si duket nuk po përputhet fillimi me mbarimin. Më e keqja dhe më e pakuptueshmja në gjithë këtë është se çdokund po luftohet njeriu për hir të kulturës, qytetërimit, fesë, e nga ana tjetër humbet kuptimi se a thua vallë luftojnë kultura, qytetërimi apo njeriu. Është mirë të bëhet dallimi në këtë: njeriu është krijesa më e çmuar, më e lartësuar në botë. Ai është më i lartësuar edhe se feja. E nga ana tjetër parashtrohet pyetja se pse nuk luftohen ideologjitë dhe fetë, faktikisht pse nuk luftohet Zoti (nëse ua mban), e të lihet i qetë njeriu. As "kulturat" as "qytetërimet" nuk janë kultura e qytetërimi nëse nuk janë në shërbim të njeriut. Multikulturalizmi, multikonfesionalizmi janë dhe mbeten pasuri dhe mbështetje për njëra-tjetrën.

Fukujama shumë mirë e titulloi librin e tij që mund të jetë edhe si përgjigje ndaj atij të Huntingtonit, sepse po nëse me të vërtetë teoria e përlëshjes mes qytetërimeve merret si teori mbi të cilën do të vazhdojë të rindërtohet "politika" globale, atëherë përgjigja do të ishte fundi i historisë dhe njeriu i fundit. Mirëpo, sërish ngel shpresa se Huntingtoni ka harruar të merret me "qytetërimet" e planeteve të tjera?!? Vepra e tij nuk është e mbështetur mbi kulturën dhe qytetërimin, por mbi strategji të pashpjeguar të klaneve dhe korporatave. Është shumë interesante dhe do të thoja edhe e lezetshme se mendja teologjike fetare në botë dëshmoi një pjekuri shumë të lartë dhe këtë teori të Huntingtonit e dënuan si të papërshtatshme dhe siç thashë edhe më lart, si "lajm" i fasikut dhe e zbuluan brendësinë e tij, duke thënë se roli i feve është udhëzimi, dashuria dhe paqja – njerëzimin mos e prekni por nëse mundeni ndihmoheni. Do të përfundoj duke e parafrazuar Andre Malraux i cili ka thënë se duke iu falënderuar njerëzve të urtë dhe të arsyeshëm religjioni megjithatë do të luajë rol pozitiv për fatin e shekullit 21.

F. Nelkovski: *Cilat janë masat, këshillat etj. të cilat i propozoni për bashkësitë fetare në Maqedoni për parandalimin e mundësisë për keqpërdorimin populist të religjioneve?*

I. Bardhi: Unë një kohë të gjatë kam qenë ligjërues dhe dekan i Fakultetit të Shkencave Islame në Shkup, gjegjësisht kam qenë anëtar aktiv i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë. Por, në këtë rast do të flas në mënyrë të paanshme, gjegjësisht vetëm si besimtar, sepse institucionet fetare, pa marrë parasysh qofshin të krishtera apo islame që i kemi tek ne, kanë pasur dhe kanë rëndësi dhe përgjegjësi të mëdha për shpirtin dhe zemrën e këtij vendi. Ato merren me brendësinë shpirtërore të njeriut. Pastaj ato kanë edhe të drejta historike shumë më të hershme se historia e shteteve. Që mos të thellohem shumë në të kaluarën, do të ndalem vetëm në periudhën e socializmit dhe post-socializmit, apo "demokracisë" tek ne.

Komunizmi, apo socializmi ynë, bashkësitë fetare i konsideroi si reaksionare, antiprogresive. Në atë periudhë vërehet ajo ana më stagnuese e këtyre institucioneve, drejtpërsëdrejti roli i tyre asokohe ka qenë ai i një shërbimi funeral. Kjo periudhë kohore për shqiptarët ka qenë dhe mbetet enigmë, ose si krizë e mendjes së shëndoshë. Preokupimi i zhvillimit të teologjisë dhe kulturës religjioze as që ka mund të vërehet. Këtë nuk e them për t'i ofenduar ata të kaluarit që kanë dhënë shpirtin dhe zemrën për fenë dhe për institucionin, por e them për atë anën tjetër e cila neve na kushton shumë shtrenjtë, sepse frigoriferin e kemi të zbrazët për mendimet e ndryshme teologjike, të cilat sot studiohen në botë. Megjithatë, edhe asokohe bashkësitë fetare në Kroaci dhe Slloveni, ishin krejtësisht më të gjalla, për dallim nga institucionet fetare tek ne. Kisha katolike e Kroacisë edhe në atë kohë është konsideruar si avangardë e ideve dhe projekteve të ndryshme të ekumenizmit dhe kulturës religjioze madje edhe për shumë vende të Evropës. Nuk e di pse të ndodhë kjo diskrepancë.

Bashkësia Fetare Islame, gjegjësisht bashkësia fetare e muslimanëve, nuk ka treguar pjekurinë e lartë dhe përgjegjësinë institucionale për t'i bërë një rrezistencë të duhur sistemit të atëhershëm, por për fat të keq kemi rastin që edhe sot në mesin tonë të ketë njerëz si kjo që po del në shesh kohëve të fundit në Poloni dhe gjetkë. Ky sherr i spiunave dhe shërbëtorëve të serviseve të ndryshme është bërë si molla e Ademit dhe Havës dhe për fat të keq kjo çështje heshtet. Edhe këtu ndodhi i njëjti paradoks, ata të cilët ishin funksionarë të ish-sistemit, u bënë funksionarë edhe të këtij sistemi. Institucionet fetare nuk kanë nevojë të marrin bekimin e politikës dhe politikanëve, por t'i ndihmojnë mirëqenies së popullsisë e më këtë edhe të shtetit, sepse çdo shoqëri ka nevojë për njerëz të devotshëm dhe që e kanë frikë Perëndinë. Këtu natyrisht se nuk duhet harruar shkatërrimin e pasurisë së institucioneve fetare asokohe, prishjen e faltoreve dhe të kulturës dhe qytetërimit qoftë krishter qoftë islam apo ndonjë tjetër.

Periudha e tranzicionit dhe bashkësia fetare për arsye të bagazhit të mëparshëm akoma nuk mund të ecë qëndrueshëm mbi këmbët e veta. Ajo fatkeqësisht nuk është e vetëdijshme për përgjegjësinë dhe rolin në këtë kohë të vështirë kur pandërprerë me orë të tëra sulmohen në mediat botërore. Ajo nuk din se si do të ballafaqohet me "liritë dhe të drejtat" njerëzore, që parashtrohen nga fuqitë vendimmarrëse të shekullarizmit dhe scientizmit; ku do ta ketë vendin e vet në Evropën e bashkuar; në ekumenizmin dhe dialogun brenda-religjioz; si do të krijojë kushte për studimin e teologjisë dhe bashkëpunimin me institucionet si në vend ashtu edhe jashtë; krijimin e kuadrit i cili do të dijë të përdorë gjuhën, pamjen për të komunikuar me fëmijët në sferën e mësim-besimit. Këtu kemi edhe gjëra shumë më të thella se këto, siç janë vetë teologjia dhe filozofia e teologjisë dhe krijimi i institucioneve të ndryshme për mbrojtjen dhe studimin e tyre, që janë tanimë kërkesë e kohës nëpër qendrat më të mëdha botërore. Jemi bërë vend me plot teologë e pa teologji.

Natyrisht se fuqia e populizmit ka qenë dhe akoma mbetet prezente në hapësirën muslimane, apo në përgjithësi fetare, tek ne. Ne kemi teologë të cilët tërë angazhimin e vet e mbështesin mbi dëshirat dhe kërkesat e njerëzve, të "besimtarëve", pa marrë parasysh se pandërprerë e keqpërdor mësimin e fesë. Keqpërdorimi është bërë në interpretimin dhe glorifikimin e mentalitetit ekzistues, duke ia dhënë atributin e shenjtë fetar, duke e glorifikuar prapambeturinë dhe kulturën pazareske të muslimanëve vetëm e vetëm që ai të ketë rolin e "mesihut". Duke përdorur këtë fuqinë e populizmit ka krijuar rrjetin e vet i cili u ka shërbyer vetëm fraksioneve të ndryshme. Nuk ka ditur të flasë për fetë qiellore, siç janë Krishterimi dhe

Judaizmi. Ne duhet ta dijmë se një teolog i cili flet kundër feve qiellore duke e mbrojtur vetëm njërin prej tyre, bën gabimin më të madh. Ndasitë dhe ndryshimet janë çështje të teologëve që pandërprerë dëgjojnë zërin e këtyre problemeve, por jo si probleme që thërrasin në dhunë dhe çrregullim shpirtëror. Është fakt se fetë qiellore i kanë parimet të quajtura dogmatike, kuptimin e të cilave për fat të keq interpretimet e teologëve vetëm se i kanë ngarkuar dhe vështirësuar. Por kjo duhet të na shërbejë brenda lirisë së asaj që thotë Kur'ani: “mua feja ime e juve feja juaj”.

Si përfundim do ta parafragoza Djuro Shushnjiqin i cili thotë se njeriu gjatë historisë shumë pak ndryshon. Ai i ndryshon vetëm rrethanat e jashtme, mirëpo reagimet ndaj atyre rrethanave kryesisht mbeten të njëjta dhe prandaj çdo gjë në histori përsëritet. E unë personalisht kisha dashur që të përsëriten vetëm gjërat e mira.